



Global Sustainable Tourism Council

Kriteret e KGTQ për Industrinë

VERSIONI 3, 21 Dhjetor 2016

ME

Indikatorët e Performancës të Sugjeruar për Operatorët Turistik

Parathënie

Kriteret e Këshillit Global për Turizëm të Qëndrueshëm (KGTQ) u hartuan për të ofruar një konceptim unik në gjithë botën për “turizmin e qëndrueshëm”, dhe janë minimumi që çdo biznes turizmi duhet të aspirojë të përmbush. Ato janë të organizuara rreth katër temave kryesore: planifikimi efikas i qëndrueshmërisë, maksimizimi i përfitimeve sociale dhe ekonomike për komunitetin lokal, përmirësimi i trashëgimisë kulturore dhe reduktimi i efekteve negative në mjedis. Këto kritere kanë zbatueshmëri në të gjithë industrinë e turizmit.

Kriteret janë hartuar dhe rishikuar me synimin që t’i përmbahen Kodit të Vendosjes së Standardeve të Aleancës ISEAL, organ i miratuar për ofrimin e udhëzimeve mbi normat ndërkombëtare për zhvillimin e standardeve të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët. Kriteret rishikohen çdo 3 deri 5 vjet. Planet për rishikime dhe regjistrime të avancuara për mendimin e publikut për rishikimet në të ardhmen janë të disponueshme në www.gstcouncil.org. Faqja e internetit ofron gjithashtu informacion për procesin dhe historikun e hartimit të Kritereve.

Disa nga përdorimet e Kritereve përfshijnë si në vijim:

- Shërbejnë si bazë për certifikimin për qëndrueshmëri.
- Shërbejnë si udhëzues bazë për bizneset e të gjitha madhësive për t’u bërë më të qëndrueshëm, dhe ndihmojnë bizneset të zgjedhin programe të turizmit të qëndrueshëm që përmbushin këto kritere globale.
- Ofrojnë askes më të madh në treg, në një treg në rritje për produkte të qëndrueshme, duke shërbyer si udhëzues si për udhëtarët ashtu edhe për agjencitë turistike në përzgjedhjen e ofruesve dhe programeve të turizmit të qëndrueshëm.
- Ndhmojnë konsumatorët të identifikojnë programe dhe biznese turizmi të qëndrueshëm.
- Shërbejnë si statistika të përgjithshme për mediumet e informacionit për të njohur ofruesit e turizmit të qëndrueshëm.
- Ndhmojnë në certifikim dhe në programe të tjera vullnetare për t’u siguruar që standardet e tyre plotësojnë një bazë të pranuar gjerësisht.

- Ju ofrojnë programeve qeveritare, joqeveritare dhe sektorit privat një pikënisje për zhvillimin e kërkesave për turizëm të qëndrueshëm.
- Shërbejnë si udhëzues bazë për organizmat arsimore dhe trajnuese, siç janë shkollat e turizmit dhe universitetet.
- Demonstrjnë drejtim që frymëzon të tjerët të veprojnë.

Kriteret tregojnë se çfarë duhet të bëhet, jo si do të bëhet ose nëse objektivi është realizuar. Ky rol përmbushet nga treguesit e performancës, materialet mësimore përkatëse dhe aksesit në mjetet për zbatim, që të gjitha janë plotësues të domosdoshëm të Kriterëve të KGTQ.

Zbatimi i Kriterëve

Rekomandohet që të gjitha kriteret të zbatohen në masën më të madhe praktike, përveç kur në një situatë specifike kriteri nuk është i zbatueshëm dhe kjo është e justifikuar. Mund të ketë rrethana në të cilat një kriter nuk është i zbatueshëm për një produkt specifik turistik, duke marrë parasysh kushtet rregullatore lokale, mjedisore, sociale, ekonomike ose kulturore. Në rastin e bizneseve të turizmit mikro dhe në pronësi të komunitetit, të cilat kanë një ndikim të vogël social, ekonomik dhe mjedisor, pranohet që burimet e kufizuara mund të parandalojnë zbatimin gjithëpërfshirës të të gjitha kriterëve. Udhëzime të mëtejshme për këto kriterë mund të gjenden në indikatorët mbështetës dhe fjalorin e botuar nga KGTQ.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës të prezantuar këtu janë hartuar për të ofruar udhëzime për matjen e përputhshmërisë me Kriteret e KGTQ për Hotelet.

Ky draft i paketës së indikatorëve do të përditësohet në mënyrë periodike, me marrjen e informacioneve të reja. Nëse dëshironi të sugjeroni indikatorë të rinj ose përmirësime të tjera, ju lutemi dërgoni sugjerimet tuaja në accreditation@gstccouncil.org

Indikatorët e Kombinuar dhe Kriteret

Ky dokument përmban Kriteret dhe Indikatorët e Performancës.

KRITERET E KGTO PËR INDUSTRIJË	INDIKATORËT PËR HOTELET
SEKSIONI A: Demonstrimi i menaxhimit të qëndrueshëm efektiv	
<p>A1 Sistemi për menaxhim të qëndrueshëm</p> <p>Organizata ka zbatuar një sistem afatgjatë për menaxhim të qëndrueshëm që përfshin me madhësinë dhe qëllimin e tij, që adreson çështjet mjedisore, sociale, kulturore, ekonomike, çështjet e cilësisë, e të drejtave të njeriut, shëndetit, sigurisë, menaxhimit të riskut dhe krizave dhe bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësime.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Sistemi për Menaxhim të Qëndrueshëm është i dokumentuar qartësisht. b. Sistemi për MQ mbulon çështjet mjedisore, sociale, kulturore, ekonomike, të cilësisë, e të drejtave të njeriut, shëndetit dhe sigurisë. c. Sistemi për MQ merr në konsideratë menaxhimin e riskut dhe krizës. d. Evidenca të dokumentuara pasqyrojnë zbatimin e sistemit për MQ. e. Sistemi për MQ përfshin procesin e monitorimit të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së qëndrueshme.
<p>A2 Përputhshmëria ligjore</p> <p>Organizata është në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe rregulloret lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë ndër të tjera, aspektet shëndetësore, të sigurisë, punës dhe mjedisit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Lista e të gjithë kërkesave ligjore përditësohet vazhdimisht. b. Certifikatat ose evidenca të tjera të dokumentuara provojnë përputhshmërinë me të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. c. Kërkesat ligjore të të gjitha vendeve ku operohet janë kuptuar dhe zbatuar.
<p>A3 Raportimi dhe komunikimi</p> <p>Organizata ja komunikon politikat e veta të qëndrueshmërisë, veprimet e ndërmarra dhe performancën aktorëve, përfshirë konsumatorët dhe kërkon të marrë angazhimin dhe mbështetjen e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Raporte të vazhdueshme për qëndrueshmërinë e performancës vihen në dispozicion. b. Politikat dhe veprimet për qëndrueshmërinë raportohen në materialet për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm. c. Komunikimet përmbajnë mesazhe që ftojnë konsumatorët dhe aktorët për mbështetje.
<p>A4 Përfshirja e personelit</p> <p>Personeli përfshihet në zhvillimin dhe zbatimin e sistemit për zhvillim të qëndrueshëm dhe merr udhëzime dhe trajnime periodike në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e veta për zbatimin e tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Evidencat për përfshirjen e personelit në sistemin për MQ janë të disponueshme. b. Të dhënat për kurset dhe trajnimin në vendin e punës, me nivelet e pjesëmarrjes, janë të disponueshme. c. Materialet e trajnimit dhe udhëzimit të personelit janë të disponueshme në formate të aksesueshme (përfshirë në gjuhën e minoriteteve, kur është nevoja). d. Personeli ka certifikata dhe kualifikime në disiplinat/afetësitë përkatëse.
<p>A5 Eksperienca e konsumatorëve</p> <p>Kënaqësia e konsumatorit, përfshirë aspektet e qëndrueshmërisë, monitorohet dhe ndermerren masa korrigjuese.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Ekziston sistemi i feedback-ut të konsumatorëve, së bashku me analizat e rezultateve. b. Feedback-u negativ dhe reagimet përkatëse regjistrohen. c. Ka evidenca të masave korrigjuese të ndërmarra. d. Feedback-u i konsumatorëve i përcillet bizneseve të turizmit dhe destinacioneve të kontraktuara/vizituara.
<p>A6 Promocioni korrekt</p> <p>Materialet promovuese dhe komunikimet për marketing janë korrekte dhe transparente për çka i përket organizatës dhe produkteve të shërbimeve, përfshirë pretendimet për qëndrueshmëri. Organizata nuk pretendon me shumë nga çka mund të ofrojë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Imazhet e përdorura në promovim janë nga eksperiencat reale të ofruara dhe produktet e realizuara. b. Marketingu rreth jetës së egër dhe aktiviteteve kulturore nuk premtim vizita që nuk mund të ofrojë. c. Pretendimet për qëndrueshmëri bazohen në të dhënat e performancave në të shkuarën.

<p>A7 Godinat dhe infrastruktura</p> <p>Planifikimi, vendndodhja, projektimi, ndertimi, rinovimi, venia ne funksion dhe shembja e godinave dhe infrastruktures...</p>	<p>Indikatorët për kriterin A7 i përkasin godinave dhe infrastrukturës që janë në zotërim dhe përdoren nga organizata ose mbi të cilat ajo ka influencë/kontroll të drejtëpërdrejtë.</p>
<p>A7.1 Përputhshmëria</p> <p>...përputhen me kërkesat dhe ligjet e vendndodhjes në lidhje me zonat sensitive dhe të mbrojtura dhe që marrin në konsideratë trashëgiminë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Demonstrrohet ndërgjegjësim për, dhe përputhshmëri me ligjet, në lidhje me përdorimin e tokës dhe veprimtarive në zonën lokale. b. Të gjitha licencat dhe lejet e kerkuara jane te perditesuara c. Demonstrrohet ndërgjegjësim për, dhe përputhshmëri me planet dhe udhëzimet jo-formale për menaxhimin e zonës (p.sh., për zona dhe projekte të veçanta).
<p>A7.2 Impakti dhe integriteti</p> <p>...merret në konsideratë kapaciteti dhe integriteti natyror dhe kulturor i zonës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Përzgjedhja e vendndodhjes, projektimi dhe aksesit kanë marr parasysh kënaqësinë vizuale, peizazhin, trashëgiminë kulturore dhe natyrore. b. Përzgjedhja e vendndodhjes, projektimi dhe aksesit kanë marr parasysh mbrojtjen e zonave biologjikisht sensitive dhe kapacitetin asimilues të ekosistemeve. c. Është ruajtur integriteti i siteve arkeologjike të trashëgimisë kulturore dhe të vendeve të shenjta. d. Është ruajtur integriteti dhe lidhja midis siteve natyrore dhe zonave të mbrojtura. e. Speciet e rrezikuara ose të mbrojtura nuk janë zhvendosur dhe ndikimi në të gjitha habitatet e jetës së egër është minimizuar dhe zbutur. f. Rrjedhat e ujit/pellgjet natyrore/ligatinat nuk janë ndryshuar, kullimi i tokës është reduktuar ku ka qenë e mundur dhe mbetjet janë kapur ose kanalizuar dhe filtruar. g. Faktorët e riskut (përfshi ndryshimet klimatike, fenomenet natyrore dhe siguria e vizitorëve) janë vlerësuar dhe adresuar. h. Vlerësimi i impakteve (përfshi impaktet e përgjithshme) është kryer dhe dokumentuar siç duhet.
<p>A7.3 Praktika dhe materiale të qëndrueshme</p> <p>...përdoren materiale dhe praktika të qëndrueshme të përshtatshme për zonën.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Për godinat dhe projektimin e tyre janë përdorur materiale, praktika dhe zejtaria lokale, kur ka qenë e mundur dhe e përshtatshme. b. Për peizazhin dhe dekorimin janë përdorur bimë të zonës dhe endemike, të siguruar nga burime të qëndrueshme, duke shmangur speciet ekzotike dhe invazive. c. Bimët e përzgjedhura kanë aftësinë të durojnë kushtet atmosferike mbizotëruese ose të paparashikuara, p.sh. bimë që durojnë thatësinë. d. Në godina janë përdorur projekte, materiale dhe praktika ndërtimi të qëndrueshme, me certifikimet përkatëse kur ka qenë e mundur e. Mbetjet nga ndërtimet seleksionohen dhe depozitohen në mënyrë të shëndetshme për mjedisin.
<p>A7.4 Akses për të gjithë</p> <p>.....ofrohet akses dhe informacion për personat me nevojë të veçanta, kur është rasti i duhur.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Sitet, godinat dhe veprimtaritë janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe nevojë të tjera të veçanta, në përputhje me natyrën e operacionit. b. Informacioni i qartë dhe i saktë ofrohet në nivel të aksesueshëm. c. Aksesueshmëria certifikohet ose inspektohet nga organizatat e ekspertëve/përdoruesve.

<p>A8 Të drejtat mbi tokën, ujin dhe pronën</p> <p>Marrja nga organizata e të drejtave mbi tokën, ujërat dhe pronën është e ligjshme, përputhet me të drejtat lokale, komunale dhe autoktone, përfshi dakordësimin e tyre të lirë, paraprak dhe të informuar dhe nuk kërkon zhvendosje të pavullnetshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Për sitet në pronësi dhe të menaxhuara nga organizata ose mbi të cilat ajo ushtron influencë/kontroll të drejtpërdrejtë, pronësia mbi tokën dhe të drejtat e pronësisë janë dokumentuar. b. Të drejtat e përdoruesit dhe për akses në burimet kryesore, përfshi tokën dhe ujin, janë të dokumentuara kur është e mundur. c. Ka evidenca të dokumentuara të komunikimeve, konsultimeve dhe përfshirjes me komunitetet lokale dhe autoktone d. Evidenca të dokumentuara të dakordësimit të lirë, paraprak dhe të informuar të komuniteteve lokale, kur është e mundur (që tregojnë se nuk ka zhvendosje ose marrje të tokës në mënyrë të pavullnetshme.)
<p>A9 Informacioni dhe interpretimi</p> <p>Organizata ofron informacion për dhe interpretimin e mjediseve natyrore të zonës, kulturës lokale, trashëgimisë kulturore si dhe shpjegime për sjelljen e duhur ndërsa vizitohen sitet e zonave natyrore, të kulturës lokale dhe trashëgimisë kulturore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Për vizitorët përgatiten dhe ofrohen materiale informimi/interpretimi për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të zonës. b. Personeli është informuar dhe trajnuar për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të zonës përreth. c. Vizitorëve ju ofrohet informacion për sjelljen e duhur në zonën përreth.
<p>A10 Përfshirja e destinacionit</p> <p>Kur ekzistojnë mundësitë, organizata përfshihet në planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të turizmit në destinacion.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata është në kontakt me Organizatën lokale për Menaxhimin e Destinacionit ose të ndonjë organi ekuivalent, në ato vendndodhje që ajo është më aktive. b. Organizata përfshihet në planifikimin dhe menaxhimin e turizmit të qëndrueshëm në ato destinacione ku ajo është më aktive.

SEKSIONI B: Maksimizimi i përfitimeve sociale dhe ekonomike për komunitetin lokal dhe minimizimi i impakteve negative

<p>B1 Mbështetja e komunitetit</p> <p>Organizata mbështet aktivisht iniciativat për zhvillimin infrastrukturor dhe social të komunitetit. Shembujt e iniciativave përfshijnë projekte për arsimin, trajnimin, shëndetësinë, higjienën publike dhe projekte që adresojnë impaktet e ndryshimeve klimatike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata mbështet iniciativat e komuniteteve lokale në zonat ku ajo është veçanërisht aktive. b. Niveli dhe lloji i kontributeve për skemat për komunitetet lokale dokumentohet. c. Kur përzgjedh ofruesit e shërbimeve dhe produkteve/përvojave që do të përfshihen në programe, organizata favorizon ata që mbështesin komunitetet lokale.
<p>B2 Punësimi i banorëve lokal</p> <p>Banorëve lokal ju jepen mundësi të barabarta për punësim dhe avancim në karrierë, përfshi në pozicione menaxhimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata përpiqet të ofrojë mundësi punësimi për banorët lokal në bizneset dhe veprimtaritë e veta. b. Organizata monitoron nivelin dhe raportin e punësimit që i ofrohet banorëve lokal. c. Banorëve lokal ju ofrohen trajnime për të përmirësuar shanset e tyre për punësim. d. Në përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve dhe të mirave/eksperiencave pjesëmarrëse në program, organizata i jep përparësi atyre që ofrojnë punësim vendas.

<p>B3 Blerje lokale</p> <p>Kur blen dhe ofron produkte dhe shërbime, organizata i jep përparësi furnitorëve lokal dhe të ndershëm nëse ata ekzistojnë dhe ofrojnë cilësinë e kërkuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata rregullisht inspekton burimet e furnizimit me produkte dhe shërbime. b. Kur përzgjedh ofruesit e shërbimeve dhe produkteve/përvojave që do të përfshihen në programe, organizata favorizon ata që janë në zotërim të dhe menaxhohen nga komunitetet lokale.
<p>B4 Sipërmarrësit lokal</p> <p>Organizata mbështet sipërmarrësit lokal për prodhimin dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të qëndrueshme, sidomos ata që operojnë në zonat natyrore, historike dhe kulturore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Kur është e volitshme, organizata ofron këshillime dhe mbështetje për ofruesit lokal të shërbimeve me të cilët ajo bashkëpunon, në lidhje me qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të tyre. b. Kur është e mundur, merren në konsideratë dhe stimulohen sipërmarrjet dhe partneritetet e përbashkëta me sipërmarrësit lokal.
<p>B5 Shfrytëzimi dhe ngacmimi</p> <p>Organizata ka një politikë kundër shfrytëzimit ose ngacmimit tregtar, seksual ose të formave të tjera, veçanërisht të fëmijëve, adoleshentëve, grave, minoriteteve ose grupeve të tjera vulnerabël</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata e ka të dokumentuar politikën kundër shfrytëzimit dhe ngacmimit të grupeve vulnerabël. b. Ndërmerren veprime për komunikimin dhe zbatimin e politikës. c. Organizata përfshihet me komunitetin lokal, në destinacionet ku ajo është veçanërisht aktive, për të punuar kundër shfrytëzimit dhe ngacmimit. d. Ruhën të dhënat e moshës së punonjësve dhe ato tregojnë se nuk ka shfrytëzim të punës së fëmijëve (sipas përkufizimit të OBP). e. Organizata mbështet veprimet kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm. f. Ofruesit dhe mjediset e shërbimit ku ka evidenca të ndonjë shfrytëzimi të mundshëm, nuk kontrahohen apo vizitohen.
<p>B6 Mundësi të barabarta</p> <p>Organizata ofron mundësi punësimi, përfshi në pozicione menaxhimi, pa diskriminim ndaj gjinisë , racës, besimit, paaftësisë ose në mënyra të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata ka identifikuar grupet e rrezikuara nga diskriminimi, përfshi gratë dhe minoritetet. b. Monitorohet numri i punonjësve të punësuar nga secili grup. c. Promovimi i brendshëm përfshin anëtarët e këtyre grupeve.
<p>B7 Puna e mirë</p> <p>Të drejtat për punë respektohen, ofrohet një mjedis pune i sigurt dhe i siguar dhe punonjësve u jepet të paktën një pagë minimale. Punonjësve ju ofrohen rregullisht trajnime, eksperiencia dhe mundësi për të avancuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata demonstroi ndërgjegjësim për, dhe përputhshmëri me, standardet dhe rregulloret ndërkombëtare të punës. b. Monitorohet dhe rishikohet rregullisht niveli i pagave, duke ju referuar nivelit kombëtar të pagës minimale. c. Mbahen të dhëna për trajnimin e personelit, duke treguar nivelin dhe shpeshtësinë e tyre. d. Kontratat e punonjësve tregojnë që paguhen sigurimet shëndetësore dhe shoqërore. e. Objektet e ujit, kanalizimeve dhe higjienës janë të aksesueshme nga të gjithë punonjësit. f. Monitorohet kënaqësia e punonjësve. g. Sistemi i ankesave të punonjësve është funksional.
<p>B8 Shërbime për komunitetin</p> <p>Veprimtaritë e organizatës nuk rrezikojnë ofrimin për komunitetet përreth të shërbimeve bazë si ushqimi, uji, energjia dhe përkujdesi shëndetësor dhe sanitar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata monitoron impaktin e vet në disponueshmërinë e shërbimeve lokale. b. Është në funksion një mekanizëm për komunikim/feedback/ankesa nga komunitetet lokale. c. Adresohet ndonjë reduktim në disponueshmërinë e shërbimeve bazë për komunitetin, kur ky është rrjedhojë e veprimtarisë së organizatës.

<p>B9 Mjetet e jetesës së komunitetit lokal</p> <p>Aktivitetet e organizatës nuk ndikojnë negativisht në aksesin nga vendasit në mjetet e jetesës, përfshi përdorimin e tokës dhe burimeve ujore, të drejtave për kalim, transport dhe strehim.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Akses i vendasve në mjetet e jetesës është marr parasysh në vendimet për zhvillim dhe kryerjen e operacioneve. b. Funksionon një mekanizëm që komunitetet lokale të raportojnë ndonjë rast të reduktimit të aksesit të komunitetit lokal në mjetet e jetesës në zonat ku zhvillohet biznesi/vizitat.
---	--

SEKSIONI C: Maksimizimi i përfitimeve për trashëgiminë kulturore dhe minimizimi i impakteve negative	
<p>C1 Ndërveprimet kulturore</p> <p>Organizata ndjek praktikata e mira ndërkombëtare dhe kombëtare dhe udhëzuesit e dakordësuar në nivel lokal për menaxhimin dhe promovimin e vizitave në komunitetet autoktone dhe në site kulturore ose historike sensitive, për të minimizuar efektet negative dhe maksimizuar përfitimet e komunitetit dhe kënaqësinë e vizitorëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata demonstroi ndërgjegjësim për, dhe përputhshmëri me, praktikata e mira ekzistuese ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale dhe udhëzimet për vizitat e turistëve në site kulturore dhe komunitetet autoktone. b. Organizata angazhohet me komunitetet/sitet në rishikimin e udhëzuesve dhe hartimin e dakordësimit e udhëzimeve shtesë sipas nevojës. c. Udhëzuesit përdoren dhe komunikohen me efikasitet. d. Ekzistojnë masa të veçanta për të shmangur ndërveprimin e papërshtatshëm me fëmijët. e. Organizata përfshihet në/ dhe mbështet trajnimin dhe përdorimin e guidave lokale. f. Kur përcaktohet madhësia e grupeve dhe shpeshësia dhe orari i vizitave, merret në konsideratë kapaciteti dhe brishtësia e siteve dhe komuniteteve, si dhe niveli i presionit mbi to. g. Inkurajohet marrja e feedback-ut nga komunitetet lokale dhe vizitorët, mbi bazën e të cilit merren masat përkatëse.
<p>C2 Mbrojtja e trashëgimisë kulturore</p> <p>Organizata kontribuon në mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pronave lokale, siteve dhe traditave me rëndësi historike, kulturore dhe shpirtërore dhe nuk e pengon aksesin në to të banorëve lokal.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata jep dhe mban shënim kontribute financiare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në zonat kryesore të operimit/vizitave. b. Organizata ofron mbështetje në natyrë ose të llojeve të tjera për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në zonat kryesore të operimit/vizitave. c. Organizata sigurohet që aktivitetet e saj të mos pengojnë aksesin e banorëve lokal në site.
<p>C3 Prezantimi i kulturës dhe trashëgimisë</p> <p>Organizata çmon dhe përfshin në operacionet e veta elementë autentik të kulturës bashkëkohore lokale, kompozime, zburime, kuzhinën, ose dyqane, ndërkohë që respekton të drejtat për pronësinë intelektuale të komuniteteve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Sitet që vizitohen dhe eksperiencat që ofrohen përçojnë eksperiencat unike të kulturës dhe trashëgimisë lokale. b. Trashëgimia kulturore e ruajtur deri në ditët e sotme dhe traditat janë të dukshme në kuzhinën, shitjen me pakicë, aktivitete dhe shërbime të tjera. c. Të drejtat e autorit dhe të pronësisë intelektuale zbatohen dhe për këtë janë marr lejet e nevojshme. d. Për prezantimin e trashëgimisë kulturore lokale është kërkuar këndvështrimi i komunitetit lokal.
<p>C4 Artefakte</p> <p>Artefaktet historike dhe arkeologjike nuk shiten, tregtohen ose ekspozohen, përveç kur lejohet nga ligji ndërkombëtar apo lokal.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Përdorimi i ndonjë artefakti është transparent dhe/ose i dokumentuar dhe raportuar. b. Aty ku përdoren artefaktet, janë identifikuar ligjet dhe aktet nënligjore që e lejojnë këtë përdorim. c. Vizitorëve nuk u lejohej ti lëvizin apo dëmtojnë artefaktet.

SEKSIONI D: Maksimizimi i përfitimeve për mjedisin dhe minimizimi i impakteve negative	
D1 Ruajtja e burimeve	
<p>D1.1 Blerjet e mallrave miqësorë për mjedisin</p> <p>Politikat e blerjes favorizojnë furnitorët dhe produktet miqësore për mjedisin, përfshi pajisje, produkte ushqimore, pije, materiale ndërtimi dhe materiale konsumi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Ekziston dhe është e dokumentuar politika e blerjeve të produkteve miqësore për mjedisin. b. Preferohen produkte dhe furnitorë me certifikatë mjedisore – veçanërisht për drurin, letrën, peshkun, produkte të tjera ushqimore, dhe produkte nga natyra. c. Kur nuk ekzistojnë produkte dhe furnitorë të certifikuar, merret në konsideratë origjina dhe metodat e rritjes ose prodhimit. d. Speciet e rrezikuara nuk përdoren ose shiten. e. Ofruesit e shërbimeve dhe operatorë të tjerë të përzgjedhur dhe të përfshirë në turne kanë certifikata mjedisore/qëndrueshmërie, kur kjo është e mundur. f. Kur nuk ekzistojnë biznese të certifikuara, merret në konsideratë qëndrueshmëria e performancës së ofruesve të cilëve u kërkohet të bëhen përmirësimet e nevojshme.
<p>D1.2 Blerje efikase</p> <p>Për të minimizuar mbetjet, organizata menaxhon me kujdes blerjen e mjeteve të konsumit dhe mallrave të konsumit, përfshi ushqimet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Preferohen blerjet e produkteve të ripërdorshme, rikthyeshme dhe riciklueshme. b. Blerja dhe përdorimi i mallrave dhe mjeteve të konsumit monitorohen dhe menaxhohen. c. Paketimi i panevojshëm (veçanërisht ai plastik) shmanget, duke blerë me shumicë, sipas mundësisë.
<p>D1.3 Kursimi i energjisë</p> <p>Matet konsumi i energjisë sipas llojit dhe ndërmerren masa për minimizimin e konsumit të përgjithshëm. Organizata bën përpjekje për rritjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Monitorohet dhe menaxhohet konsumi total i energjisë në të gjitha operacionet e organizatës dhe në bizneset që ai ka nën kontroll. b. Favorizohen burimet e rinovueshme dhe raporti i energjisë së rinovueshme me totalin e furnizimit me energji, monitorohet dhe menaxhohet. c. Për minimizimin e përdorimit të energjisë përdoren pajisjet dhe praktikatat përkatëse. d. Janë përcaktuar objektivat për reduktimin e shpenzimit të energjisë. e. Personelit dhe vizitorëve u jepen udhëzime për minimizim të shpenzimit të energjisë.
<p>D1.4 Kursimi i ujit</p> <p>Vlerësohet risku i mungesës së ujit, matet konsumi i ujit sipas llojit, dhe ndërmerren hapa për minimizimin e konsumit të përgjithshëm. Burimi i ujit është i qëndrueshëm dhe nuk ka efekte negative në burimet mjedisore.</p> <p>Në zonat me rrezik të lartë të mungesës së ujit, identifikohen dhe zbatohen objektiva mbi bazën e kontekstit dhe ndërmerren hapa për minimizimin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Vlerësohet dhe dokumentohet rreziku i mungesës së ujit në destinacionet kryesore të vizituara. b. Në destinacionet ku rreziku i mungesës së ujit është vlerësuar si i lartë, përcaktohen objektiva për administrimin e ujit. c. Monitorohet dhe menaxhohet uji i përdorur në operacionet kryesore të organizatës dhe në ato që ajo ka influencë/kontroll të drejtpërdrejtë. d. Për minimizimin e konsumimit të ujit përdoren pajisje dhe praktika. e. Uji vjen nga burim i ligjshëm dhe i qëndrueshëm, që nuk ka pasur, dhe nuk ka gjasa të ketë, ndikime negative në burimet mjedisore. f. Merren në konsideratë impaktet e përgjithshme të turizmit në burimet lokale të ujit. g. Janë përcaktuar objektivat për reduktimin e konsumit të ujit. h. Personeli dhe vizitorët janë udhëzuar për minimizimin e përdorimit të ujit.

D2 Reduktimi i ndotjes	
<p>D2.1 Emetimi i gazrave serrë</p> <p>Emetimet e konsiderueshme të gazrave serrë nga të gjitha burimet e kontrolluara nga organizata identifikohen dhe llogariten. Kur është e mundur, zbatohen procedura për ti shmangur ose minimizuar ato. Inkurajohet neutralizimi i çdo emetimi të mbetur.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Monitorohet dhe menaxhohet emetimi total, ai direkt dhe indirekt, i gazrave serrë. b. Monitorohet dhe menaxhohet sasia e gazit karbonik të emetuar nga turist/natë. c. Ndërmerren hapa për të shmangur dhe reduktuar emetimet e konsiderueshme të shkaktuara nga të gjitha burimet e kontrolluara nga organizata. d. Ndërmerren hapa për të inkurajuar furnitorët e shërbimeve dhe produkteve të shmangin emetimin e lartë vjetor. e. Kur është e mundur përdoren mekanizma për neutralizimin e karbonit.
<p>D2.2 Transporti</p> <p>Organizata kërkon të reduktohen nevojat për transport dhe inkurajon fort përdorimin e alternativave nga burime më të pastra dhe efikase nga gjithë konsumatorët, punonjësit dhe furnitorët në të gjitha operacionet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Ku është praktike dhe e mundur, për programet e turneve dhe ekskursioneve përdoren opsione transporti më të pastra dhe efikase. b. Konsumatorëve u ofrohet dhe promovohet informacion për alternativat (miqësore me mjedisin) e transportit si për mbërritjen, largimin dhe gjatë vizitës. c. Alternativat e mundshme për transport (p.sh., biçikleta me qira, ndarja e automjetit me të tjerë udhëtar, marrja nga/dërgimi në aeroport) ofrohen ose mundësohen për vizitorët dhe personelin. d. Favorizohen tregjet e zonës ose ato që ofrojnë mundësi transporti të qëndrueshëm. e. Favorizohen furnitorët lokal dhe operacionet e përditshme përpiqen të minimizojnë përdorimin e transportit.
<p>D2.3 Ujërat e zeza</p> <p>Ujërat e zeza, përfshi ujin gri, trajtohen me efikasitet dhe ripërdoren ose shkarkohen në mënyrë të sigurt, pa efekte negative në popullatën ose mjedisin lokal.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata është e vetëdijshme për praktikat e trajtimit të ujërave të zeza në destinacionet kryesore të vizituara, dhe përpiqet të influencojë përmirësimin e tyre kudo që është e nevojshme dhe e realizueshme. b. Ujërat e zeza që gjenerohen nga operacionet kryesore të organizatës dhe bizneset mbi të cilat ajo ka influencë/kontroll të drejtpërdrejtë, shkarkohen në një sistem trajtimi të miratuar nga bashkia apo qeveria, nëse një i tillë ekziston. c. Nëse sistemi bashkiak i trajtimit të ujërave të zeza nuk ekziston, në vendndodhjen e biznesit ka një sistem (që plotëson kërkesat ndërkombëtare të cilësisë së ujërave të zeza) dhe që garanton se nuk ka efekte negative në popullatë dhe mjedis.
<p>D2.4 Mbetjet e ngurta</p> <p>Mbetjet, përfshi mbetjet ushqimore, maten. Funksionojnë mekanizma për reduktimin e mbetjeve. Kur reduktimi nuk është i mundshëm, mbetjet ripërdoren ose riciklohen. Asnjë mbeturinë e mbetjeve të depozituara nuk ka efekt negativ në popullatën dhe mjedisin lokal.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata është e vetëdijshme për praktikat e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në destinacionet e vizituara, dhe përpiqet të influencojë përmirësimin e tyre kurdo që është e mundur. b. Ekziston plani i menaxhimit të mbetjeve të ngurta të gjeneruara nga operacionet e destinacionit dhe bizneset në të cilat ai ka influencë/kontroll të drejtpërdrejtë c. Plani i menaxhimit të mbetjeve të ngurta përfshin reduktimin, ndarjen, ripërdorimin ose riciklimin e mbetjeve ushqimore, kur është e mundur. d. Depozitimi i mbetjeve bëhet në vende të menaxhuara ose miratuara nga qeveria dhe ka evidenca që këto vende nuk kanë efekte negative në popullatë ose mjedisin lokal. e. Matet sasia e mbetjeve të ngurta të depozituara dhe janë përcaktuar objektivat për minimizimin e mbetjeve të pandryshueshme. f. Vizitorët dhe personeli janë udhëzuar si të reduktojnë mbetjet.

<p>D2.5 Substancat e dëmshme</p> <p>Përdorimi i substancave të dëmshme, përfshi pesticide, bojëra, disinfektantë për pishina, dhe materiale për pastrim minimizohen, dhe kur është e mundur zëvendësohen me produkte të padëmshme. Menaxhohen me kujdes ruajtja, përdorimi, trajtimi dhe depozitimi i kimikateve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Kryhet inventari i materialeve të dëmshme dhe plotësohet e ruhet formulari i sigurisë së materialeve të dëmshme (FSMD). b. Ndërmerren veprime për sigurimin e më shumë alternativave miqësore me mjedisin. c. Kimikatet, veçanërisht ato në sasi të madhe, ruhen dhe trajtohen në përputhje me standardet përkatëse. d. Vizitorët informohen për përdorimin personal të substancave që mund të konsiderohen të dëmshme për mjedisin përreth (si krem plazhi toksik apo kremra kundër insekteve).
<p>D2.6 Minimizimi i ndotjes</p> <p>Organizata zbaton praktika për minimizimin e ndotjes nga zhurma, drita, derdhjet, erozioni, substancat që shkaktojnë erozion, dhe ndotjen e ajrit dhe tokës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Burimet potenciale të ndotjeve të përshkruara në kriter rishikohen dhe identifikohen. b. Burimet potenciale të ndotjeve të përshkruara në kriter monitorohen. c. Ndërmerren veprime për minimizimin dhe , kur është e mundur, eliminimin e ndotjeve të përshkruara në kriter.
<p>D3 Ruajtja e biodiversitetit, ekosistemeve dhe peizazheve</p>	
<p>D3.1 Ruajtja e biodiversitetit</p> <p>Organizata mbështet dhe kontribuon në ruajtjen e biodiversitetit, përfshi përmes menaxhimit të mirë të pronave të veta. Vëmendje e veçantë tregohet për zonat natyrore të mbrojtura me vlerë të lartë të biodiversitetit. Çdo ndërhyrje në ekosistemet natyrore minimizohet dhe rehabilitohet dhe, ka një kompensim për kontributin në menaxhimin e ruajtjes.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata demonstroi ndërgjegjësim për zonat natyrore të mbrojtura dhe me vlerë të lartë të biodiversitetit në zonat e vizituara. b. Organizata ofron dhe regjistron mbështetjen monetare për ruajtjen e biodiversitetit në zonat e operimit/vizituara. c. Organizata ofron dhe regjistron mbështetjen në natyrë dhe lloje të tjera për ruajtjen e biodiversitetit në zonat e operimit/vizituara. d. Pronat në zotërim ose në përdorim nga organizata dhe ato të bizneseve mbi të cilat ajo ka influencë/kontroll të drejtpërdrejtë menaxhohen në mënyra që mbështesin ruajtjen e biodiversitetit. e. Organizata është e vetëdijshme për dhe redukton aktivitetet me potencial për të çrregulluar jetën e egër dhe habitatet. f. Ku ka pasur çrregullime jepet kompensim. g. Merren masa për inkurajimin e vizitorëve të mbështesin ruajtjen e biodiversitetit. h. Organizata përfshihet me OJQ-të lokale për ruajtjen e biodiversitetit në zonat kryesore ku ajo operon.
<p>D3.2 Speciet invazive</p> <p>Organizata merr masa për të shmangur hyrjen e specieve invazive. Speciet lokale përdoren në terrenin përçark dhe kur është e realizueshme, për përmirësimin e tij, veçanërisht në terrene natyror.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Pronat në zotërim ose në përdorim nga organizata dhe ato të bizneseve mbi të cilat ajo ka influencë/kontroll të drejtpërdrejtë monitorohen për prezencën e ndonjë specie invazive. b. Merren masa për tu siguruar që speciet invazive nuk janë futur apo përhapur. c. Është përgatitur programi për shfarosjen dhe kontrollin e specieve invazive. d. Këqyret terreni i siteve për të konsideruar përdorimin e specieve të zonës.
<p>D3.3 Vizitat në sitet natyrore</p> <p>Organizata zbaton udhëzimet përkatëse për menaxhimin dhe promovimin e vizitave në sitet natyrore, me qëllim minimizimin e impakteve negative dhe maksimizimin e kënaqësisë së vizitorëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata është e vetëdijshme për, dhe zbaton, udhëzimet ekzistuese për vizitat turistike në sitet natyrore. b. Udhëzimet përdoren gjatë vizitave dhe për informimin e vizitorëve. c. Organizata përfshihet me organet lokale të mbrojtjes për identifikimin/ përmirësimin e çështjeve në lidhje me vizitat në site të veçanta. d. Organizata nxit dhe mbështet trajnimin dhe përfshirjen e udhëzuesve lokalë në atraksionet natyrore. e. Kur përcaktohet madhësia e grupeve dhe shpeshësia dhe ora e vizitave, merret në konsideratë kapaciteti dhe brishtësia e siteve dhe komuniteteve, si dhe niveli i presionit mbi to. f. Inkurajohet dhënia e feedback-ut nga komunitetet lokale dhe vizitorët, mbi bazën e të cilit merren masat përkatëse.

<p>D3.4 Ndërveprimi me jetën e egër</p> <p>Ndërveprimet me kafshët e egra që lëvizin lirisht, duke marr parasysh impaktet totale-nuk janë invazive dhe menaxhohen me përgjegjshmëri për të shmangur efektet negative në kafshët në fjalë dhe në qëndrueshmërinë dhe sjelljen e këtyre popullatave në natyrë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata është e vetëdijshme për, dhe zbaton, rregulloret dhe udhëzimet ekzistuese lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me ndërveprimin me kafshët e egra, përfshi vëzhgimin e tyre. b. Organizata përfshihet për hartimin dhe zbatimin e kodeve dhe udhëzuesve lokal për ndërveprimin me jetën e egër, përfshi vëzhgimin e kafshëve të egra sikurse kërkohet, bazuar në këshillat e ekspertëve të jetës së egër. c. Organizata sigurohet që të gjithë ofruesit e shërbimeve dhe sitet të vizituara janë në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet ekzistuese lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me ndërveprimin me speciet e egra, përfshi vëzhgimin e tyre. d. Ndërveprime direkte, veçanërisht të ushqyerit, nuk duhet të lejohet, veçse nëse sanksionohet specifikisht nga standardet e pranuar botërisht. Kur standardet nuk janë të disponueshme, ndiqen këshillat e ekspertëve të pavarur të jetës së egër. e. Merren masa për të minimizuar shqetësimin e kafshëve të egra. f. Impaktet në mirëqenien e jetës së egër monitorohen dhe adresohen rregullisht.
<p>D3.5 Mirëqenia e kafshëve</p> <p>Asnjë specie e kafshëve të egra nuk mund të kapet, mbarështohet, ose mbahet në kafaz përveçse nga personat e autorizuar dhe me pajisjet përkatëse dhe, për veprimtari të lejuara me rregullore në zbatim të ligjit lokal dhe ndërkombëtar.</p> <p>Strehimi, kujdesi dhe trajtimi i kafshëve të egra dhe atyre shtëpiake duhet të përmbushin standardet më të larta të mirëqenies së kafshëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata është e vetëdijshme për, dhe zbaton, ligjet dhe rregulloret përkatëse për kafshët e egra të kapura. b. Zbatohen udhëzuesit ekzistues për aktivitete turistike të veçanta që kanë lidhje me kafshët e egra të kapura. c. Personeli përgjegjës për kafshët e egra të kapura ka kualifikimet dhe eksperiencën përkatëse dhe është i licencuar. d. Organizata është e vetëdijshme për, dhe zbaton, ligjet dhe rregulloret përkatëse për mirëqenien e kafshëve. e. Organizata sigurohet që të gjitha shërbimet e ofruara dhe sitet e vizituara janë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe udhëzuesit përkatës në lidhje me mbajtjen në kafaz dhe mirëqenien e kafshëve të egra. f. Bëhen inspektime të vazhdueshme për kushtet e kafshëve të egra dhe strehimin e tyre. g. Bëhen inspektime të vazhdueshme për kushtet e kafshëve shtëpiake, për strehimin dhe trajtimin e tyre.
<p>D3.6 Kapja dhe tregtimi i kafshëve të egra</p> <p>Speciet e jetës së egër nuk kapen, konsumohen, ekspozohen, shiten apo tregtohen, përveçse kur janë pjesë e aktiviteteve të ligjshme që garantojnë se përdorimi i tyre është i qëndrueshëm dhe në përputhje me ligjet lokale dhe ndërkombëtare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Organizata është e vetëdijshme për, dhe zbaton, ligjet dhe rregulloret përkatëse për kapjen dhe tregtimin e kafshëve të egra. b. Organizata sigurohet që të gjitha shërbimet e ofruara dhe sitet e vizituara janë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe udhëzuesit përkatës në lidhje me kapjen dhe tregtimin e kafshëve të egra. c. Vizitorët informohen për rregulloret në lidhje me kapjen e kafshëve të egra, konsumimin dhe tregtimin e tyre, dhe që duhet të shmangin blerjen e produkteve/suvenirëve të paligjshëm me prejardhje nga kafshët e egra të rrezikuara, të shpallura të tilla nga UICN ose CITES d. Kur gjuetia është veprimtari e ligjshme, ajo është pjesë e qasjes me bazë shkencore e menaxhuar siç duhet dhe zbatuar me përpikëri.